

Gjykata e Qarkut në Prishtinë, si gjykatë e shkallës së dytë me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarja e EULEX-it Verginia Micheva-Ruseva, si kryesuese e kolegjit dhe gjyqtarët Nehat Idrizi dhe Rafet Haxhaj, anëtarë të kolegjit, në kontestin ndërmjet paditësit FG dhe të paditurës KG për kompensimin e dëmit, në bazë të ankesave të paditësit dhe të paditurës kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Glllogovc në C.nr. 116/08, datë 27 shtator 2011, pas një seance të këshillimit të mbajtur më 6 nëntor 2012 nxjerr si më poshtë:

AKTGJYKIM

Refuzohen ankesat e FG dhe KG të datës 27 dhe 28 tetor 2011 ndaj aktgjykimit të Gjykatës Komunale të Glllogovcit të nxjerrë nën C.nr. 116/ 08 dhe vërtetohet aktgjykimi i shkallës së parë

Refuzohet kërkesa e ankuesit KG për kompensimin e shpenzimeve gjyqësore në shkallën e dytë.

Arsyetim

1. HISTORIA PROCEDURALE:

Kontesti nisi me një padi depozituar në Gjykatën Komunale të Glllogovcit më 15 prill 2005. Gjykata Komunale një herë kishte vendosur lidhur me të nën C.nr. 65/2005. Pas një ankese të njëjës prej palëve, Gjykata e Qarkut të Prishtinës u mor me kontestin duke vendosur që të anulohet vendimin e shkallës së parë dhe ta kthejë çështjen për rigjykim (Vendimi i 21.02.2006 në AC.nr.282/2006. Më parë në Gjykatën Komunale kontesti ishte regjistruar nën C.nr.116/2008. Më 05.12. 2008 procedura u pezullua pasi që Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave ishin njoftuar në lidhje me kontestin për shkak të kushteve të nenit 67 dhe 68 të Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Ligji 03-L-048). EULEX-i mori përsipër rastin në shkallë të parë përmes një vendimi të datës 08 dhjetor 2009. Gjykata Komunale në Glllogovc, si gjykatë e shkallës së parë vendosi në 27 shtator 2011 me një aktgjykim, me miratimin e pjesërishëm të padisë. Kundër këtij vendimi gjyqësor të shkallës së parë, paditësi dhe e paditura me kohë i kishin parashtruar ankesat e tyre më 27 dhe 28 tetor 2011, respektivisht. Ankesat iu ishin dërguar palëve për një përgjigje ndaj ankesës më 16 mars 2012. EULEX-i e mori përsipër rastin në shkallë të dytë me një vendim të datës 09 shkurt 2012.

2. KËRKESAT DHE POZITA E TË PADITURËS GJATË PROCEDURËS NË SHKALLËN E PARË:

Paditësi ka paraqitur në gjykatë këto gjashtë kërkesa bazuar në pretendimet e tij se me prishjen e pronës së tij e paditura kishte shkelur Ligjin mbi Marrëdhëniet Detyrimore ("Zakon o obligacionim odnosima" Gazeta zyrtare e RSFJ-së 29/1978, ndryshimet në nrs. 39/85, 45 / 89,31 / 93, neni 154, në gjuhën angleze të përkthyer kryesisht si Law on Obligations and Torts):

- (1) Kompensim për lokalin afarist të rrënuar në një vlerë prej 45.600 Euro, (950 Euro për m², në bazë të sipërfaqes së përgjithshme të dyqanit, 48 m², duke përfshirë nënkulmin);
- (2) Kompensim për inventarin e humbur në një shumë prej 13.100 euro;
- (3) Kompensim për fitimin e humbur në një shumë prej 600 euro në muaj që nga data 1 mars 2005;
- (4) Kompensim për vuajtjet shpirtërore / dëm jomaterial në një vlerë prej 7.000 euro;
- (5) Caktimi nga ana e të paditurës i një ngastre të ngjashme për lokal afarist;
- (6) Kamatat mbi shumat e pretenduara nën 1, 2, 3 dhe 4 të llogaritura sipas kamatës për depozitat e kursimit në bankat e Kosovës.

Për më tepër, paditësi ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve procedurale në shumën prej 1004 Euro.

E paditura i kundërshtoi pretendimet, duke deklaruar se KG kishte plotësisht të drejtë që ta lironte ngastrën (duke përfshirë prishjen e dyqanit) dhe nuk kishte shkelur asnjë ligj, pasi që kontrata e nënshkruar mes palëve parashikonte që pronarët duhej t'i largonin dyqanet e tyre, nëse kërkohej nga e paditura . E paditura ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve procedurale në shumën prej 611Euro.

3. FAKTET

I. RRETHANAT E RASTIT

Sipas asaj që ka gjetur gjykata e shkallës së parë, si dhe konkluzioneve faktike të Gjykatës Supreme të Kosovës, në aktgjykimet e saj A.nr.19/2001 dhe A.nr.443/2004, është vërtetuar kjo gjendje faktike:

Në vitin 1996 KG, nëpërmjet një vendimi të datës 15.11.1996, ia kishte dhënë paditësit një ngastër toke për shfrytëzim të përkohshëm, e referuar si Asanajka, parcela kadastrale nr 763, nr 41 në KG me një sipërfaqe prej 25m², nën obligimin për të ndërtuar një dyqan në ngastrën në fjalë. Më 08.07.1997 ajo gjithashtu ia dha lejen e ndërtimit të objektit. Objekti afarist (një dyqan dykatësh, me sipërfaqe të përgjithshme prej 48 m²) ishte ndërtuar aty dhe ishte përdorur për qëllime afariste gjatë disa viteve. Më 29 mars 2001 KG urdhëroi pronarët që t'i largonin objektet afariste.

Paditësi, si pronar i lokalit afarist, parashtroi ankesë ndaj këtij vendimi të Shefi Ekzekutiv i KG.

Shefi Ekzekutiv nuk vendosi lidhur me ankesën.

Paditësi parashtroi ankesë kundër Shefit Ekzekutiv për heshtje administrative të Gjykata Supreme e Kosovës.

Gjykata Supreme me një vendim në rastin A.nr.19/2001 të datës 27. 07. 2001 e aprovoi padinë dhe e urdhëroi Shefin Ekzekutiv të vendosë për kërkesën e pronarit.

Ndërkohë, paditësi së bashku me pronarët e tjerë të dyqaneve, të cilët gjithashtu kishin marrë vendimin e njëjtë të KG për rrënimin e objekteve të tyre afariste, ngritën padi para Gjykatës Komunale të Glllogocit kundër KG për pengimin në posedim. Arsyeja ishte se më 3 dhe 4 prill 2001 KG filloi me rrënimin e disa lokaleve afariste të pronarëve. Në Gjykatën Komunale ishin regjistruar dy raste lidhur me pengimin në posedim – C.nr. 50/ 2001 dhe C. Nr. 53/ 2001. Në rastin C.nr. 50/ 2001 Gjykata e Komunale e aprovoi padinë dhe vendosi një masë të përkohshme të sigurisë ku ia ndalonte KG rrënimin e dyqaneve. Në rastin C.nr.53/2001 kërkesa për shqiptimin e masës së përkohshme ishte refuzuar.

Paditësi ishte palë në rastin C.nr.53/2001.

Ndërkohë, Ombudspersoni i Kosovës kërkoi nga Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) që të shtyjë ekzekutimin.

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të UNMIK-ut me një urdhër ekzekutiv 2001/6, datë 07.05.2001 e shtyu ekzekutimin.

KG e zbatoi urdhrin e UNMIK-ut dhe me një vendim të 24.08.2001 e shtyu ekzekutimin.

Më 25.02.2002 Drejtoria për Inspektim në Komunën e Glllogocit nxori një Konkluzion që lejonte ekzekutimin e vendimit të 29.03.2001.

Gjykata Supreme e Kosovës në rastin A.nr.109/2002 datë 26.02.2004 e anuloi këtë vendim të Drejtorisë për Inspektim.

Më 5.05.2004 Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit e KG përsëri lëshoi një vendim, duke e anuluar vendimin e 15.11.1996 dhe duke i urdhëruar pronarët, duke e përfshirë edhe këtë paditës, që t'i largojnë objektet e tyre afariste.

Më 31.05.2004, duke vepruar lidhur me ankesën e pronarëve, Shefi Ekzekutiv i KG e konfirmoi këtë vendim.

Më 19.10.2004, duke vepruar lidhur me ankesën e pronarëve, Ministria e Mjedisit e konfirmoi vendimin e Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit të 05.05.2004.

Pronari paraqiti ankesë ndaj këtij vendimi në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Më 25.01.2005 Drejtoria për Inspektim e KG nxori një konkluzion që lejonte ekzekutimin e aktvendimit të Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit në kuadër të KG të lëshuar më 05.05.2004, duke e urdhëruar paditësin që ta largonte objektin e tij nën kërcënimin se nëse ai nuk e largon atë brenda 8 ditësh, atëherë lokali i tij do të largohet me forcë.

Më 31. 01. 2005 paditësi paraqiti ankesë kundër këtij konkluzioni drejtuar Shefit të Ekzekutivit.

Më 15. 02. 2005 KG nxori një vendim për mbylljen (plumbimin) e lokalit afarist të paditësit për shkak të mungesës së lejes së punës.

Më 1 dhe 2.03.2005 KG e rrënoi lokalin afarist të paditësit. Inventari brenda objektit u shkatërrua.

Më 21.03.2005 Gjykata Supreme e Kosovës në aktgjykimin e saj A.nr.443/2004 e anuloi vendimin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

II. LIGJI PËRKATËS

Në bazë të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9, 15. 05. 2001, të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/9, 03.05.2002, që ishte në fuqi deri kur u miratua Kushtetuta e Kosovës në vitin 2008), Kapitulli 3

“3.1 Të gjithë personat në Kosovë gëzojnë, pa diskriminim të asnjë lloji dhe në barazi të plotë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

3.2 Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes respektojnë dhe sigurojnë standardet e pranuar në arenën ndërkombëtare të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke përfshirë ato të drejta dhe liri të parashtruara në: Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut; Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e tij; Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike të Njeriut dhe Protokollet e tij; Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial; Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas; Konventën për të Drejtat e Fëmijëve; Kartën Evropiane të Gjuhëve Rajonale apo Minoritare dhe Kornizën e Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare.

3.3 Dispozitat për të drejtat dhe liritë e parashtruara në këto instrumente aplikohen në Kosovë drejtpërsëdrejti si pjesë e këtij Kornize Kushtetuese”.

Sipas Kapitullit 9.4.2,

“Çdo person që pohon se është prekur drejtpërdrejt dhe në mënyrë të dëmshme nga një vendim i Qeverisë ose i një organizmi ekzekutiv nën përgjegjësinë e Qeverisë, ka të drejtën e rishqyrtimit gjyqësor të ligjshmërisë së atij vendimi pasi të jenë shterur të gjitha rrugët e rishqyrtimit administrativ”.

Sipas Nenit 33 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave në Kosovë, 11.08.2000,

“Ligji dhe drejtësia e obligojnë administratën e komunës që të zbatojë në veçanti të drejtat dhe liritë e njeriut sipas Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut. Të gjitha veprimet administrative duhet të jenë në përputhje me ligjin në fuqi”.

Neni 2.4 parashikon se:

“Çdo komunë e ka statusin e vet juridik, të drejtën për të poseduar dhe administruar pronën, mundësinë për të ushtruar padi dhe për të qenë i paditur në gjykata, të drejtën për të lidhur kontrata dhe të drejtën për të marrë punëtorë në punë”.

Neni 35 i po kësaj rregullore të UNMIK-ut parasheh:

35.1 “Çdo qytetar mund të parashtojë ankesë kundër vendimit administrativ të komunës, nëse ai apo ai mendon se me atë vendim i janë cënuar të drejtat e tij apo të saj. Ankesat duhet t’i dorëzohen me shkrim Shefit Ekzekutiv ose personalisht zyrës së Shefit Ekzekutiv brenda afatit prej një muaji pasi parashtruesi i ankesës të jetë njoftuar për atë vendim”.

35.2. Shefi ekzekutiv duhet ta rishqyrtojë ligjshmërinë e vendimit si dhe procesin administrativ me të cilin është arritur ai vendim. Ai ose ajo duhet të ofrojë një përgjigje të arsyeshme me shkrim brenda një muaji ditësh nga data e pranimit të ankesës.

35.3. Nëse nuk është i kënaqur me përgjigjen e Shefit Ekzekutiv, parashtruesi i ankesës mund t’i drejtohet Pushtetit Qendror, i cili e shqyrton ankesën dhe vendos për ligjshmërinë e atij vendimi.

35.7 Të drejtat e përcaktuara me këtë nen janë të drejta shtesë të çfarëdo të Drejtave, të cilat personi mund t’i ketë për t’ia paraqitur një vendim administrativ Ombudspersonit apo ndonjë gjykate”.

Për më tepër, Neni 36 parashikon:

“Qytetari mund të kërkojë zgjidhje për vendimet e ndonjë komune në pajtim me rregullat dhe procedurat e gjykatës përkatëse”.

Neni 47 përcakton kompetencat e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm që do të përmenden, në mënyrë që të jemi më të qartë:

47.1 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) e mban tërë pushtetin që i është dhënë me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Ai e ka fjalën përfundimtare në marrjen e vendimeve përkitazi me çdo dispozitë të këtij Rregulloreje.

47.2 PSSP mund të anulojë çdo vendim të komunës nëse konsideron se është në kundërshtim me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, Rregulloret e UNMIK-ut apo ligjet tjera në fuqi dhe nëse ato vendime nuk i marrin parasysh aq sa duhet të drejtat dhe interesat e komuniteteve që jetojnë në territorin e asaj komune”.

Përveç këtij, shqyrtimi administrativ i vendimeve administrative ishte rregulluar edhe me Ligjin për Procedurën Administrative (Gazeta Zyrtare e RSFJ-s, Nr 47, 15/08/1986). Ky Ligj ishte në fuqi deri më 13.11.2006, kur Ligji i ri mbi procedurën administrative (Ligji N0 02/L-28), hyri në fuqi.

Shqyrtimi gjyqësor i vendimeve administrative rregullohet me Ligjin mbi Kontestet Administrative (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së N04, të 14.01.1977). Nëse pala e dëmtuar është e pakënaqur me vendimin përfundimtar të organit administrativ, mund të parashtrohet ankesë gjyqësore në Gjykatën Supreme. Vendim përfundimtar administrativ do të konsiderohet vendimi i nxjerrë në bazë të ankesës administrative ose vendim administrativ i shkallës së parë kundër të cilit nuk lejohet ankesa administrative (Neni 7). Procedura mund të fillohet brenda 30 ditësh nga dita kur vendimi administrativ iu është dorëzuar palës (neni 24). Nëse Gjykata Supreme e gjen parashtruesin si të pranueshëm, atëherë ai mund ta anulojë aktin administrativ të kontestuar dhe të udhëzojë autoritetet administrative se si të veprojnë ose mund të lëshojë një vendim të karakterit zëvendësues që zëvendëson aktin origjinal administrativ.

Neni 17 i këtij ligji përcakton se:

"Ankesa, si rregull, nuk e pengon ushtrimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur.

Me kërkesën e paditësit, organi, akti i të cilit ushtrohet, d.m.th. organi përgjegjës për ekzekutimin e tij në rastin e një akti të lëshuar nga një organ që nuk është i autorizuar për ekzekutimin e tij, do të shtyjë ekzekutimin deri në marrjen e vendimit përfundimtar të gjykatës, në qoftë se ekzekutimi i aktit do të shkaktonte dëme të riparueshme për paditësin dhe shtyrja as nuk do të ishte në kundërshtim me interesin publik dhe as nuk do t'i shkaktonte dëm më të madh të riparueshëm palës kundërshtare. Së bashku me kërkesën për shtyrje duhet të futet edhe prova mbi ankesën e parashtruar. Për çdo kërkesë, organi kompetent duhet të sjellë një vendim jo më vonë se brenda 3 ditëve nga marrja e kërkesës. Organi sipas paragrafit 2 të këtij neni, mund të shtyjë ekzekutimin e aktit përkatës, deri në vendimin përfundimtar të gjykatës për arsye të tjera gjithashtu, nëse interes publik e lejon këtë."

Sa i përket bazës ligjore mbi të cilat paditësit i është dhënë e drejta e shfrytëzimit të tokës, Gjykata kujton nenin 14 të Ligjit mbi Tokën Ndërtimore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës, nr 14/80):

"Komuna mund të jep tokën urbane jo-ndërtimore për ndërtim, në të cilën ai ka të drejtën e dispozicionit, dhe tokën e kontraktuar në shfrytëzim të përbashkët për shfrytëzim të përkohshëm për nevoja të përkohshme".

Sipas nenit 20.3 të këtij ligji:

"Personat, të cilët marrin për shfrytëzim parcelën për ndërtim, janë të detyruar, që brenda afatit prej 3 vjetësh nga dita që ata e marrin vendimin, ta ndërtojnë objektin, apo të kryejnë një punë të konsiderueshme të tij".

Sipas nenit 24 të njëjtit ligj:

"Pronari i një ndërtese në tokë urbane për ndërtim ka të drejtë të shfrytëzojë tokën nën ndërtesë dhe tokën që është e nevojshme për shfrytëzimin e tij të rregullt, brenda kufijve të parcelës ndërtimore.

E drejta për shfrytëzim e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni vazhdon për atë kohë sa ekziston ndërtesa.

Nëse objekti nga paragrafi 1 i këtij neni nuk është më i përshtatshëm për shfrytëzim, për shkak të vjetërsisë apo dëmeve të shkaktuara për shkak të vis mair, pronarit të objektit do t'i jepet prioritet për ndërtim në të njëjtën parcelë sipas kushteve të parashikuara në nenin 18 të këtij ligji.

E drejta për shfrytëzimin e tokës e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni nuk mund të transferohet fare".

Sa për përgjegjësinë për neglizhencë të KG, Gjykata rikujton nenet 170-173 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore ("Zakon o obligacionim odnosima", GZ RSFJ 29/78) duke siguruar që organizatat, punëdhënësit dhe personat e tjerë juridikë do të jenë përgjegjës për dëmet e shkaktuara nga të punësuarit e tyre ose anëtarëve të tyre, ose ia kalon një personi të tretë në kryerjen e punës apo funksionit të tyre ose në lidhje me kryerjen e punës apo funksionit.

Sipas rregullit të përgjithshëm të përcaktuar në nenin 154

"Kushdo që i shkaktonte dëmtim ose humbje tjetrit do të jetë përgjegjës për ta kompensuar atë, përveç nëse ai provon se dëmi ishte shkaktuar pa fajin e tij".

Neni 155 i të njëjtit ligj përcakton dëmtimin ose humbjen si një zvogëlim të pronës së dikujt (humbja e thjeshtë) dhe parandalimin e rritjes së tij (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi i dhimbjes fizike ose shpirtërore tjetrit ose shkaktimi i frikës (dëme jo-materiale ose ankth mendor).

Neni 185 rregullon kthimin dhe dëmshpërblimin në formën e parave:

- 1) Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e ekzistuar para se të shkaktohej dëmi.
- 2) Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë kompensim në të holla.
- 3) Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundshme apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që ta bëjë këtë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t'ia paguajë dëmtuesit shumën përkatëse në të holla për efekt të kompensimit të dëmit.
- 4) Gjykata do t'i gjykojë dëmtuesit kompensimin në të holla kur ai e kërkon këtë me përjashtim kur rrethanat e rastit konkret justifikojnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme.

Neni 186 parashikon se kur rrjedh për pagesë detyrimi i kompensimit:

“Detyrimi i kompensimit të dëmit konsiderohet se rrjedh për pagesë që nga momenti i shkaktimit të dëmit.

Sipas nenit 189:

- (1) I dëmtuari ka të drejtë si për kompensimin e dëmit të thjeshtë ashtu edhe për kompensimin e fitimit të munguar.
- (2) Shuma e dëmit të thjeshtë caktohet sipas çmimeve në kohën e nxjerrjes së vendimit gjyqësor me përjashtim të rastit kur ligji urdhëron diçka tjetër.
- (3) Gjatë vlerësimit të shumës së përfitimit të munguar merret në konsiderim fitimi ka mundur të pritej në mënyrë të bazuar sipas procesit të rregullt të sendeve ose sipas rrethanave të veçanta ndërsa realizimi i të cilave është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga mosveprimi.

Neni 190 parashikon se:

"Gjykata duke marrë parasysh edhe rrethanat që kanë lindur pas shkaktimit të dëmit do të gjykojë kompensimin në një shumë që nevojitet që gjendja materiale e dëmtuesit të kthehet aty ku do të ishte po të mos kishte veprim dëmtues ose mosveprim.

Sa i përket dëmit jo-material ligji parashikon si më poshtë në nenin 200:

- (1) " Për dhimbjet e pësuar fizike, për dhimbjet e pësuar shpirtërore, për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të jetës të prishjes, të shkeljes së nderit ose të lirisë, të vdekjes së personit të afërm si dhe për frikën gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit për frikën dhe zgjatja e tyre justifikon këtë, do të gjykojë kompensim të drejtë në të holla, pavarësisht nga kompensimi i dëmit material dhe nga mungesa e dëmit material.
- (2) Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jomaterial si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për

rëndësinë e vlerës së shkelur dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe për faktin se mos të u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e tij dhe me qëllimin shoqëror.“

Sipas nenit 376:

- (1) " Kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tre vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin.
- (2) Sidoqoftë, kjo kërkesë parashkruhet për pesë vjet nga data kur është krijuar dëmi.

Neni 1 i Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, drejtpërdrejt i zbatueshëm në Kosovë në vitin 2005 në bazë të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, neni 3.3, të lexohet si më poshtë:

“Çdo person fizik apo juridik ka të drejtën të gëzojë në mënyrë paqësore zotërimet e tij. Askush nuk do të privohet nga zotërimet e veta përveçse në interes të publikut dhe kur është subjekt i kushteve të përcaktuara me ligj e sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

“Dispozitat e mësipërme, sidoqoftë, nuk do të çenojnë në asnjë mënyrë të drejtën e një shteti për të zbatuar ligjet, të cilat i vlerëson si të nevojshme për kontrollin e përdorimit të pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm apo për të siguruar pagesën e taksave e kontributeve apo gjobave të tjera”.

4. VENDIMI I GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË

Gjykata Komunale e Gllogovcit, si gjykatë e shkallës së parë vendosi më 27 shtator 2011 me një vendim, duke miratuar pjesërisht pretendimet:

- (1) dhe (2) Gjykata e shkallës së parë pjesërisht ka aprovuar kërkesën për kompensim financiar të lokalit afarist të shkatërruar (dyqanit) në një vlerë prej 7200 euro, si dhe kërkesës për kompensimin e inventarit shkatërruar në dyqan në një shumë prej 1.500 euro, dhe urdhëroi që këto dy shuma të paguhen së bashku me kamatën, e cila aplikohet në përputhje me depozitat bankare për kursime për më shumë se një vit, e llogaritur nga data 15 prill 2005, kur padia ishte ngritur deri në pagesën përfundimtare.
- Gjykata pranoi se e paditura ka vepruar kundër ligjit dhe drejtësisë, kështu në kundërshtim me nenin 33 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave në Kosovë. Procedurat administrative për përfundimin e kontratës me paditësin dhe lirimimin e ngastrës nuk kishin përfunduar në kohën kur u rrënuar dyqani. KG nuk i ka marrë parasysh interesat e pronarit të dyqanit, kur e ushtroi pushtetin e saj. Për më tepër, KG nuk e shpalli një afat para të cilit duhej të liroheshin ngastrat dhe nuk e shpalli datën se kur vet KG do ta lironte ngastrën me

rrënimin e lokalit. Kështu e paditura e privoi paditësin nga mundësia për ta larguar pronën dhe inventarin e tij. Gjykata arriti në përfundimin se rrënimi i dyqanit është një shkelje e qartë e të drejtave pronësore të paditësit që janë të mbrojtura nga neni 1 i Protokollit 1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Lidhur me shumën e kompensimit, gjykata e shkallës së parë shprehu mendimin se nuk ishte e mundur që të vërtetohej shuma e saktë e dëmit të shkaktuar me rrënimin, si dhe vlera e inventarit për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar që nga viti 2005. Gjykata i ka llogaritur shpenzimet e përafërta të ndërtimit në kohën e ndërtimit dhe nuk ka marrë si bazë vlerën e tregut të dyqanit, sepse sipas kushteve të zbatueshme ndërmjet palëve, shfrytëzuesi nuk ka pasur të drejtë ta shesë lokalin. Sa për inventarin e humbur, gjykata pranoi se nuk kishte asnjë provë për inventarin e shkatërruar, dhe ky dëmtim nuk ishte i specifikuar as në padi. Gjykata e miratoi kërkesën për kompensim, duke pasur parasysh se e paditura nuk e kontestoi faktin se paditësi kishte inventar në dyqan kur ai ishte shkatërruar, dhe e aprovoi shumën e kompensimit të barabartë me çmimin e inventarit që çdo dyqan i asaj madhësie mund ta ketë.

- (3) Gjykata e shkallës së parë e refuzoi si të pabazuar kërkesën për kompensimin e fitimit të humbur, pasi ajo vendosi se ishte jokompetente për të vendosur mbi ligjshmërinë e vendimit administrativ për përfundimin e kontratës. Gjykata pranoi se e paditura do të jetë përgjegjëse për kompensimin e fitimit të humbur vetëm kur vendimi për ndërprerjen do të ishte i paligjshëm, i cili mund të vendoset vetëm në një procedurë administrative.
- (4) Gjykata e shkallës së parë pjesërisht ka aprovuar kërkesën për kompensimin e dëmit jomaterial në një vlerë prej 250 Euro. Gjykata pranoi se shkatërrimi i dyqanit dhe inventarit i kishte shkaktuar paditësit vuajtje shpirtërore. Pasi që shuma e saktë nuk mund të përcaktohej, gjykata e shkallës së parë i ndau një shumë simbolike prej 250 Euro.
- (5) Gjykata e shkallës së parë e hodhi poshtë, si të pabazë, kërkesën për caktimin e një ngastre të ngjashme për lokal afarist, pasi nuk kishte asnjë detyrim që e paditura t'i ofronte paditësit një tjetër ngastër të ngjashme të tokës. Përveç kësaj, gjykata pranoi se çështja e caktimit të një ngastre të re, do të varej nga ligjshmëria e vendimit për të përfunduar kontratën, e cila përbënte një çështje për të cilën gjykata ishte e mendimit se ajo ishte jokompetente.
- (6) Në kërkesën e fundit në lidhje me kamatën e kërkuar vazhdimisht lidhur me kërkesat 1, 2, 3 dhe 4, gjykata e shkallës së parë në vendimin e saj vendosi lidhur me secilën prej kërkesave të përmendura më lart, dhe e aprovoi kamatën për kërkesat 1 dhe 2, ndërsa e refuzoi kamatën e kërkuar lidhur me kërkesat 3 dhe 4.

Gjykata e shkallës së parë e urdhëroi të paditurën që të mbulojë shpenzimet procedurale, sepse sipas gjykatës aktivitetet e të paditurës shkaktuan lindjen e kontestit.

5. PËRMBAJTJA E ANKESAVE NDAJ AKTGJYKIMIT TË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË:

Paditësi paraqiti ankesë për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke kërkuar nga gjykata e shkallës së dytë që të ndryshojë vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të vendosë sipas thelbit të çështjes, sipas padisë së tij. Konkretisht, paditësi në ankesën e tij pretendonte se është shkelur dispozita e nenit 182.2 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, sepse dispozitivi i atij aktgjykimit është i paqartë dhe kontradiktor me arsyetimin dhe ai nuk përmban faktet vendimtare, [dhe] aktgjykimi nuk është arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme me prova dhe se ka kundërthënë ndërmjet arsyetimit të vendimit dhe përmbajtjes së dëshmive. Më konkretisht, paditësi i vuri në pyetje shumat e vendosura nga gjykata e shkallës së parë në kërkesëpaditë e aprovuara pjesërisht (1, 2, 4, 6), si dhe vendimin e gjykatës për të refuzuar kërkesëpaditë 3 dhe 5. Paditësi deklaroi se shumat e sakta ishin të specifikuara plotësisht gjatë procedurës së shkallës së parë, duke përfshirë tri ekspertiza. Paditësi konsideron se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i padrejtë.

E paditura paraqiti ankesë kundër pikave 1, 2 dhe 4 të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, si dhe kundër vendimit lidhur me shpenzimet procedurale për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke kërkuar nga gjykata e shkallës së dytë që t'i anulojë pikat 1, 2 dhe 4 të aktgjykimit, si dhe vendimin mbi shpenzimet procedurale dhe që çështjen ta kthejë për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë. E paditura pretendonte se gjykata e shkallës së parë ka shkelur nenin 182 (n) të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, sepse dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me faktet, respektivisht me dëshmitë e dokumentuara, sepse sipas këtyre dëshmive është e qartë se toka iu ishte dhënë paditësit për shfrytëzim të përkohshëm, si edhe ajo nuk qëndron se e paditura nuk ka marrë ndonjë veprim administrativ në procedurë administrative për shkatërrimin e dyqanit. E paditura pohoi më tej se vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike konsiston në faktin se në bazë të neneve 154.1 dhe 158 të Ligjit mbi Detyrimet, në mënyrë që të vërtetohet përgjegjësia për dëmin e shkaktuar, duhet të ekzistojë një dëm për shkak të veprimit të paligjshëm dhe të palejueshëm, ndërsa veprimet e të paditurës ishin të ligjshme, pasi ato janë ndërmarrë në pajtim me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Ngastra ishte dhënë për shfrytëzim të përkohshëm në pajtim me Ligjin për Tokën Ndërtimore. Pasi që dyqani nuk ishte larguar nga ngastra pas urdhrimit të së paditurës, kjo e fundit e ka larguar dyqanin në përputhje me dispozitat e aplikueshme. Konstatimi i gjykatës së shkallës së parë se, paditësit nuk i është dhënë kohë për ta liruar ngastrën, nuk është i drejtë, pasi që veprimi për rrënimin e dyqanit ishte ndërmarrë në mënyrë që të ekzekutohej vendimi për anulimin e vendimit mbi ndarjen e ngastrës dhe ky vendim iu ishte dorëzuar pronarit të lokalit. Ligji mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike përcaktonte se e drejta e pronësisë nuk mund të fitohej mbi pronën shoqërore, e kështu pra jo mbi tokën ndërtimore, e cila ishte pronë shoqërore. E paditura ka deklaruar gjithashtu se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vërtetuar se janë shkelur dispozitat e Protokollit 1 të Konventës së të Drejtave të Njeriut, sepse procedura administrative është kryer në përputhje me nenin 6 të Konventës në fjalë, që do të thotë se për largimin e ngastrave ka qenë i përfshirë interesi publik. Në fund, e paditura

e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë për shkak se ai konsideron se gjykata nuk ka një kompetencë të vërtetë për të vendosur në këtë çështje, pasi ai e konsideron atë si një çështje administrative, e cila i përket kompetencës së Gjykatës Supreme në kontest administrativ. Prandaj, e paditura konsideron se kërkesa është dashur të hidhej poshtë për shkak të jokompetencës së gjykatës.

6. VLERËSIMI I GJYKATËS SË QARKUT

A. Pranueshmëria

Para se të hyjë në konkluzionet mbi meritat Gjykata do të shqyrtojë *ex officio* pranueshmërinë e padisë. Padiësi, duke pretenduar të jetë pronari i një lokali afarist inventarit, të demoluar dhe të shkatërruar nga e paditura, ka interes ligjor për të paraqitur padi. E paditura, KG ka zotësi procedurale për t'iu përgjigjur padisë, pasi që në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave në Kosovë (i zbatueshëm në vitin 2005), Neni 2.4 Komuna e ka statusin e vet juridik dhe mund të paditet në gjykatë.

B. Meritat

Para së gjithash gjykata duhet të vendosë se cili ligj e njeh detyrimin e KG si person juridik dhe autoritet lokal. Në vitin 2005 Kosova nuk ka pasur ligj të veçantë ku vendoseshin përgjegjësitë e qeverisë dhe autoritetet lokale vetë-qeverisëse për dëmet e shkaktuara ndaj qytetarëve për shkak të neglizhencës. Prandaj, është i zbatueshëm ligji i përgjithshëm i detyrimeve (Ligji mbi marrëdhëniet detyimore, Gazeta Zyrtare RSFJ 29/78) pasi që ai i njeh përgjegjësinë e personave juridik dhe ndërmarrjeve për humbje ose dëme të shkaktuara nga personeli i tyre gjatë ushtrimit të funksioneve ose gjatë ofrimit të shërbimeve. Në vitin 2005, pavarësisht ligjit të brendshëm, ishin drejtpërsëdrejti të zbatueshme instrumentet ndërkombëtare, duke përfshirë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Konventa në nenin 1 të Protokollit 1 mbron pronat dhe pasuritë ekzistuese kundër ndërhyrjes. E drejta për shfrytëzim të përkohshëm të tokës, e drejta e pronësisë mbi një ndërtesë dhe mbi sendet e luajshme është konsideruar nga konventa si "zotërim". E drejta në bazë të nenit 1 të Protokollit 1 përfshin mundësinë për të ushtruar këto të drejta dhe ky gëzim i këtyre të drejtave është i mbrojtur ndaj ndërhyrjeve nga entet publike dhe private. Ndërhyrja mund të jetë në format e privimit apo kontrollin e shfrytëzimit, dhe duhet të ketë një qëllim të ligjshëm, t'i plotësojë të gjitha kushtet e ligjshmërisë dhe mund të ushtrohet me bilancin e drejtë ndërmjet kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kërkesës së mbrojtjes së të drejtave themelore të individit.

Gjykata e shkallës së parë e ka aplikuar vetëm Nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës për të njohur përgjegjësinë e të paditurës në disa prej padive.

Gjykata e Qarkut konsideron se duhet të zbatohet gjithashtu edhe ligji vendor në këtë kontest, natyrisht gjithmonë duke kujtuar tekstin e Konventës dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Gjykata, pas shqyrtimit të të gjitha provave të administruara, konstaton se KG ka demoluar objektin afarist të paditësit para përfundimit të kontrollit gjyqësor mbi vendimin administrativ ku urdhërohej heqja e objektit. Më 1 dhe 2 mars 2005, çështja administrative A.nr.443/2004 ishte ende në pritje në Gjykatën Supreme. Kontesti administrativ në çështjet nëse toka dhënë paditësit në vitin 1996 për shfrytëzim të përkohshëm do të merrej përsëri nga KG dhe përkatësisht nëse paditësi, si pronar i një lokali të ndërtuar në këtë ngastër në vitin 1997, do të urdhërohej për ta hequr, nuk kishte përfunduar më 1 dhe 2 mars 2005. Mjetet administrative për ankesë kundër vendimit të Drejtorisë për planifikim, urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit të datës 05/05/2004 ishin shterur, por jo mjetet gjyqësore. Paditësi, si pronarët e tjerë të më shumë se 20 dyqaneve, e kishte apeluar vendimin e Ministrisë së Mjedisit në Gjykatën Supreme, si organi gjyqësor që ushtron kontrollin gjyqësor mbi vendimet administrative të KG. KG nuk e ka pritur vendimin e Gjykatës Supreme, por lëshoi një konkluzion më 25.01.2005 duke lejuar ekzekutimin kundër pronës së paditësit, duke e larguar atë nga toka komunale, dhe kështu ka vepruar në kundërshtim me parimet e së drejtës dhe të drejtësisë të parapara si një detyrë e organit administrativ të përcaktuara në nenin 33 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave në Kosovë. KG ishte e detyruar që ta ndiqte ligjin e zbatueshëm, duke përfshirë standardet ndërkombëtare, të cilat në vitin 2005 ishin të zbatueshme drejtpërdrejt në Kosovë (shih nenin .3.3 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë). Përveç kësaj, më 31. 01. 2005 paditësi kishte paraqitur ankesë ndaj konkluzionit të Drejtorisë së Inspektimit në kuadër të KG të datës 25. 01. 2005 drejtuar Shefit Ekzekutiv, dhe lidhur me këtë ankesë nuk u lëshua asnjë vendim deri më datën 01. 03. 2005. Kështu më 1 dhe 2 mars 2005 KG veproi gjithashtu edhe para se të përfundonte kontrolli administrativ mbi aktin administrativ ku urdhërohej largimi i lokalit afarist të paditësit. Përveç kësaj më 15. 02. 2005 KG e mbylli (plumboi) lokalin afarist dhe praktikisht ia pamundësoi paditësit që vullnetarisht ta largonte dyqanin dhe inventarin që gjendej brenda në të. KG ishte e detyruar që ta ndiqte ligjin e zbatueshëm, duke përfshirë standardet ndërkombëtare, të cilat në vitin 2005 ishin të zbatueshme drejtpërdrejt në Kosovë (shih nenin .3.3 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë). Është e vërtetë se Ligji mbi Kontestet Administrative nuk parashikon shprehimisht ndalimin e ekzekutimit të vendimit administrativ të kontestuar para Gjykatës Supreme, por KG ishte e lejuar nga ligji të priste derisa të lëshohej vendimi përfundimtar i gjykatës nëse interesi publik e kërkonte atë (Neni 17). Ky opsion ligjor për Komunën, do të konsiderohet në dritën e detyrimit të përgjithshëm të KG për t' iu përmbajtur ligjit dhe drejtësisë, dhe në veçanti të drejtave dhe lirive të njeriut të përfshira në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e përmendura (neni 33 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave në Kosovë). Ekzekutimi i aktit administrativ para se Gjykata Supreme të vendosë është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, pasi që ajo mund të përjashtojë ushtrimin e plotë të mjeteve efektive dhe për këtë arsye përbën ndërhyrje në të drejtat pronësore. Një nga të drejtat themelore të njeriut është e drejta për gëzimin paqësor të posedimit. Paditësi nuk ishte një pronar i tokës, por atij iu dha e drejta për ta shfrytëzuar përkohësisht atë dhe për të ndërtuar një dyqan në të. Organi qeverisës mund ta privojë atë nga kjo e drejtë, në përputhje me interesin e përgjithshëm, dhe kjo nuk është e diskutueshme, por Gjykata konsideron se në momentin e rrënimit të dyqanit paditësi

nuk ishte privuar ende. Kjo Gjykatë është jokompetente për të shqyrtuar ligjshmërinë e këtij privimi, ajo çështje do të zgjidhet në procedurë të kontestit administrativ. Kjo Gjykatë duhet të vendosë nëse KG e ka rrënuar ligjërisht objektin afarist të paditësit, dhe në qoftë se nuk ishte e ligjshme, atëherë ta njohë përgjegjësinë e KG për të paguar kompensim për dëmet e shkaktuara ndaj paditësit, nëse ka pasur ndonjë.

Kontesti për ndërprerjen e shfrytëzimit të përkohshëm të tokës dhënë paditësit dhe më shumë se 20 qytetarëve tjerë të KG kishte mbetur pa u zgjidhur që nga viti 2001. Vendimi i KG për të marrë përsëri tokën dhe për të hequr dyqanet ishte kontestuar para Ombudspersonit të Kosovës, para Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, para Gjykatës Supreme. Të gjitha këto institucione kanë ndërhyrë kundër ekzekutimit. Për disa pronarë të dyqaneve Gjykata Komunale në Glllogovc bile vendosi edhe masa të sigurisë kundër KG ku e ndalonte atë që të rrëronte dyqanet. Kjo situatë kërkonte konsideratë nga autoritetet lokale, jo vetëm për interesat individuale të paditësit, por edhe për interesin publik, pasi që rrënimi i më shumë se 20 dyqaneve para se Gjykata Supreme ta lejonte atë, ka mundur të shkaktojë dëme të pariparueshme për më shumë se 20 familje të KG. Autoritetet lokale kanë ditur për rrezikun e dëmtimit të pronës nëse ata do të vepronin para vendimit të Gjykatës Supreme, por ata e lanë pas dore këtë. Dëmi ndaj paditësit ishte një rrjedhojë e arsyeshme e parashikueshme. Përveç kësaj, KG ka shkelur detyrën e saj, të përcaktuar në nenin 33 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave në Kosovë, për të ndjekur ligjin dhe për të mbrojtur pronën, si një e drejtë themelore e njeriut . Nuk ka asnjë dëshmi se zbatimi i projektit të sheshit "Skënderbeu" në KG ishte një çështje urgjente dhe që kërkonte lirim të menjëhershëm të tokës komunale.

Gjykata e Qarkut pajtohet me mendimin e gjykatës së shkallës së parë që e paditura i ka shkaktuar dëme materiale paditësit duke shkatërruar dyqanin e tij, bile edhe pa e njoftuar atë për ndonjë afat për ekzekutim vullnetar dhe me forcë. Paditësi ishte duke pritur që të vendosej lidhur me ankesat e tij të paraqitura para Gjykatës Supreme dhe para Shefit Ekzekutiv. Përveç kësaj, KG ia kishte mbyllur (plumbuar) dyqanin. Kështu, siç u tha më lart, ai ishte i privuar nga mundësia për ta larguar objektin dhe për ta hequr inventarin. Ekziston qartë një lidhje e rastësishme midis veprimeve të KG dhe shkatërrimit të dyqanit dhe inventarit të paditësit dhe përkatësisht dëmeve të shkaktuara. Dëmi material që iu shkaktua paditësit është shuma parave të tij të humbura - vlera e dyqanit dhe inventarit. Pasi që Gjykata Komunale saktë vuri në dukje se paditësi nuk mund ta shiste dyqanin. E drejta për ta shfrytëzuar tokën është një e drejtë individuale dhe nuk mund t'i bartet palës së tretë (shih Nenin 24.4 të Ligjit për Tokën Ndërtimore). Kjo është arsyeja pse humbja e paditësit do të matet jo me vlerën e tregut të objektit, por nga vlera e saj e ndërtimit. Kompensimet për dëmet janë dhënë për të vendosur paditësin në pozitën në të cilën ai do të kishte qenë sikur mos të ishin shkaktuar dëmet. Gjykata e shkallës së parë kërkoi nga paditësi që të specifikojë kërkesën e tij për sa i përket dëmit material të dyqanit dhe inventarit, por ai nuk e bëri. Paditësi nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi se sa para kishte paguar për ndërtimin e dyqanit dhe çfarë gjëra kishte në dyqan para rrënimit të tij. Nga ana tjetër e paditura nuk e ka kundërshtuar ekzistencën e dyqanit, praninë e inventarit në këtë dyqan dhe faktin që KG e kishte rrënuar dyqanin e kështu e kishte shkatërruar edhe inventarin. Në një rast të tillë gjyqtari mund të vendosë për shumën e kompensimit sipas masave mesatare të arsyeshme dhe duke iu përmbajtur parimit të drejtësisë. Shuma e

kërkuar prej 45 600 euro për kompensim për dyqanin prej 48 m2 (një ndërtesë e përkohshme) e llogaritur si 950 Euro për m2 është shumë e lartë dhe e pajustificuar për një vlerë të ndërtimit (jo të tregut) për një objekt të përkohshëm të ndërtuar në vitin 1997. Kompensimi vendos një vlerë monetare për dëmin e bërë, duke ndjekur parimin e restitutio in integrum. Gjykata nuk mund t'i jep paditësit kompensim për diçka që e paditura nuk është përgjegjëse. Paditësi nuk ka vënë në dukje edhe një element të inventarit që ai e kishte në dyqan para 1 dhe 2 marsit 2005, nuk ka asnjë dëshmi të gjendjes së inventarit (artikuj të rinj ose të përdorur, çfarë lloji i artikujve, etj.)

Lidhur me pretendimin për kompensimin e fitimit të humbur, Gjykata pajtohet me mendimin e gjykatës së shkallës së parë që aktivitetet afariste në dyqan vareshin nga ndërprerja e kontratës për shfrytëzim të përkohshëm të tokës mbi të cilën ishte ndërtuar dyqani. Nëse kjo ndërprerje ishte e vlefshme, atëherë dyqani nuk mund të vepronte dhe të merrte fitimin nga veprimtaria e tij. Ligjshmëria e përfundimit të kontratës për shfrytëzimin e tokës është jashtë kompetencave të kësaj Gjykate. Kjo çështje do të vendoset në procedurë/ kontest administrativ. E paditura nuk mund të jetë përgjegjëse në këtë pikë. Përveç kësaj, në bazë të paditësit dyqan ishte mbyllur (plumbuar) nga KG disa ditë para se të ndodhte rrënimi për shkaqe administrative (mungesa e lejeve të punës). Nëse është kështu, dyqani nuk ishte duke punuar para rrënimit. Paditësi nuk ka siguruar dëshmi nëse ai kishte ndërmarrë hapa për zgjidhjen e pengesave administrative pas mbylljes së dyqanit nga KG, dhe për të dëshmuar pritjet legjitime që dyqani do të jetë funksional në të ardhmen e afërt. Paditësi nuk ka ofruar asnjë dëshmi se çfarë ishin të ardhurat e tij / fitimi deri më 1 mars 2001 për ta bindur gjykatën se ai kishte pësuar një humbje të fitimit. Nuk ka asnjë dëshmi se dyqani ishte funksional dhe realizonte fitim. Kjo kërkesë u refuzua me të drejtë nga gjykata komunale, si dhe kërkesa për caktimin e një ngastre të ngjashme për lokal afarist. Nuk ka asnjë bazë ligjore për ta kompensuar dëmin e dyqanit të rrënuar dhe inventarit të shkatërruar me caktimin e një ngastre. Gjykata gjithashtu pranon se veprimet e rrënimit nga ana e KG i kanë shkaktuar paditësit vuajtje dhe dhimbje shpirtërore. Ky dëmtim gjithashtu do të kompensohet nga KG në pajtim me nenin 200 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore. Gjykata e shkallës së parë kishte urdhëruar kompensim të drejtë për paditësin. Shuma e kërkuar e dëmeve jomateriale është shumë e lartë dhe e pajustificuar. Gjykata kujton faktin se paditësi e dinte se ai nuk ishte pronari i tokës, në të cilën ai kishte ndërtuar dyqanin e tij, se objekti ishte i përkohshëm dhe një ditë dyqani do të hiqej dhe veprimtaria afariste do të mbyllej. Kompensimi është dhënë për tronditjen që ai e kishte përjetuar kur e ka gjetur dyqanin dhe inventarin të shkatërruar. Ky nuk është një kompensim për humbjen e biznesit apo fitimit. Paditësi nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi se ai kishte pësuar disa dhimbjeve të tjera, të cilat kërkojnë kompensim më të lartë (shpenzimet mjekësore, etj.) Shuma e kompensimit do të jetë në proporcion me vuajtjet. Në këtë rast nuk është e mundur të përcaktohet vlera e dëmit që iu shkaktua paditësit, pasi që nuk ekziston asnjë provë për matjen e dëmeve, që është arsyeja pse Gjykata pranon se 250 euro do të paraqesin kompensim të drejtë për dëmin jomaterial që paditësi e përjetoi. Dëmshpërblimet për dëmin material, do të paguhet nga KG me kamatën e kërkuar. Kamata ligjore mbi dëmshpërblimin jo-material, ashtu siç vendoset nga Gjykata Komunale, do të paguhet nga momenti i lëshimit të vendimit. Ligji mbi Marrëdhëniet Detyrimore nuk parashikon mundësinë ligjore për të paguar kompensim jo-material në

mënyrë retrospektive nga momenti që ka ndodhur dëmi. Neni 186 i Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore ka të bëjë vetëm me dëmin material, pasi që vendi i tij në ligj është në kapitullin "dëmshpërblim për dëmtimin e pronës". Në kapitullin "dëmshpërblim për dëmin jo material" (nenet 199-205) një dispozitë e tillë retrospektive mungon. Përveç kësaj neni 205 përcakton se vetëm "dispozitat mbi përgjegjësinë e veçantë dhe reduktimin e dëmshpërblimit i zbatueshëm për humbjen materiale do të zbatohet në përputhje me humbjen jomateriale gjithashtu". Rrjedhimisht dispozita e nenit 186 nuk është e zbatueshme për dëmet jo-materiale, dhe interesi mbi kompensimin e dhënë nuk mund të jepet.

Për shumicën e vërejtjeve të bëra në ankesat e të dyja palëve, Gjykata është përgjigjur tashmë në arsyetimin e saj më sipër. Janë disa çështje për tu shtuar.

Kjo gjykatë nuk është duke ndërhyrë në ligjshmërinë e KG për ta marrë përsëri tokën dhe zbatimin e një projekti tjetër. Kjo gjykatë nuk është kompetente edhe për të vendosur nëse KG ka vepruar në interes të publikut, kur ndërpreu kontratat për shfrytëzim të përkohshëm të tokës. Kjo çështje do të vendoset nga gjykata administrative. Siç u sqarua tashmë më lart, kjo gjykatë duhet ta konstatojë nëse e paditura kishte rrënuar në mënyrë jologjore dyqanin dhe inventarin e paditësit dhe në qoftë se është ashtu, cila është shuma e kompensimit që paditësit ka të drejtë të kompensohet.

Gjykata nuk pajtohet me mendimin e palëve të shprehura në ankesat se dispozitivi i vendimit të kontestuar është në kundërshtim me faktet përfundimtare. Konkluzionet e gjykatës së shkallës së parë janë të qarta dhe të kuptueshme të pasqyruara në dispozitiv. Gjykata e shkallës së parë ka vepruar në përputhje me detyrimet e saja të përcaktuara në nenin 8 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (Ligji Nr.03/L-006, Gazeta Zyrtare Nr.38/2008) dhe vërtetuar faktet pas shqyrtimit të kujdesshëm dhe të ndërgjegjshëm të provave dhe perceptimit të përgjithshëm të fituar gjatë procedurës, si dhe ka shqyrtuar çdo pjesë të provave.

Sa i përket çështjes së kompetencës së sfiduar të kësaj gjykate dhe gjykatës komunale, të shprehur nga ana e KG, trupi gjykues pajtohet me mendimin tashmë të shprehur nga gjykata e shkallës së parë për këtë çështje në vendimin e ankimuar (faqe 5 e versionit anglisht të vendimit).

Sa i përket mendimit të paditësit në ankesën e tij që gjykata Komunale nuk i ka pranuar konkluzionet e ekspertit në një rast të ngjashëm (XhP rasti me numër 22/05 para Gjykatës Komunale në Glogoc), Gjykata kujton se në rastin XhP, eksperti JT ka dhënë përfundimin sa i përket vlerës së tregut të një dyqani, ndoshta i ngjashëm me dyqanin e paditësit. Gjykata tashmë ka sqaruar edhe më tej arsyet për të kundërshtuar vlerën e tregut si një bazë për matjen e dëmeve materiale që paditësi i kishte pësuar.

Gjykata nuk pajtohet me deklaratën e paditësit në ankesën e tij se ai e kishte specifikuar humbjen në inventar, por megjithatë gjykata komunale nuk ia aprovoi padinë në tërësinë e saj. Kërkesa për inventarin do të kishte qenë e specifikuar, nëse paditësi do ta kishte specifikuar çdo send që e ka pasur në dyqan më 1 mars 2005, çmimi i çdo sendi përfshirë faturat e çmimit të paguar, kur i kishte blerë sendet, ose në qoftë se fatura nuk është në dispozicion, atëherë prova të tjera relevante, duke përfshirë deklaratat e dëshmitarëve. E njëjta gjë ka të bëjë me kërkesën për kompensim për fitimin e humbur. Siç u përmend më sipër, paditësi nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi se ai kishte fitim nga dyqani dhe çfarë ishte shuma e këtij fitimi. Këtu Gjykata do të kujtojë rregullin e përgjithshëm në konflikte civile, e pasqyruar në nenin 7 të Ligjit për procedurë kontestimore, që është detyrë e

secilës palë që t'i paraqet të gjitha faktet mbi të cilat bazohet padia e tij apo e saj, dhe të paraqesë prova që i vërtetojnë ato fakte. Barra e provave bie mbi paditësin. Gjykata nuk mund të vendosë përgjegjësi për të paditurin në bazë të akuzave të pavërtetuara me fakte. Për më tepër, paditësi vazhdon në ankesë se gjykata e shkallës së parë padrejtësisht refuzoi padinë e tij nën pikën 5, ndërsa ajo ishte e detyrueshme që ta kompensonte atë me një zëvendësim të tokës, ku ai mund të ndërtonte një lokal dhe të siguronte të ardhura për familjen e tij. Paditësi kurrë nuk e specifikoi para gjykatës se cila ishte baza ligjore për këtë kërkesë. Ligji (Ligji mbi Tokën Ndërtimore) nuk parashikon një mundësi të tillë. Kështu ky pretendim nuk është ligjërish i suksesshëm.

Përveç arsyeve të theksuara në ankesa, Gjykata, sipas detyrës zyrtare, në pajtim me nenin 194 të Ligjit për Procedurë Kontestimore, shqyrtoi çdo shkelje të së drejtës materiale, si dhe çdo shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore në bazë të nenit 182 paragrafi 2 pika b), g), j), k) dhe m) i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore. Nuk ka arsye për kundërshtimin e vendimit të dhënë në këtë mosmarrëveshje. Aktgjykimi i gjykatës komunale është vërtetuar.

Pasi që ankesa e KG nuk aprovohet, kërkesa e saj për kompensim për shpenzimet procedurale para gjykatës së apelit, refuzohet.

Siç u tha më lart, në bazë të nenit 200 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, është vendosur në pajtim me dispozitivin e këtij aktgjykimi.

**Gjykata e Qarkut e Prishtinës,
Ac.nr. 1329/11, datë 06. 11. 2012**

**Verginia Micheva-Ruseva
Kryesuese e kolegjit**

**Nehat Idrizi
Anëtar i kolegjit**

**Rafet Haxhaj
Anëtar i kolegjit**

**E përkthyer nga:
Mesere Kovaqi, EULEX 0479L**